



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-69854/23, më 30. 03. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, me 28/04, qershor 2008), nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, nenit 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) për Metodologjinë e Vlerësimit të dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, komisioni është në këtë përbërje:
 - 2.1. Xhevdet Ibrahimaj - Drejtori për Siguri dhe Emergjencja, Kryetar;
 - 2.2. Xhymshit Gashi - Drejtori për Siguri dhe Emergjencja, Anëtar;
 - 2.3. Veton Demolli - Drejtorja e Inspektionit, Anëtar;
 - 2.4. Agim Cukaj - Drejtorja e Bujqësisë, Anëtar;
 - 2.5. Afërdita Hasimi - Drejtorja e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Anëtar.
3. Sekretar i Komisionit caktohet Xhevdet Ibrahimimi i cili do të veprojë në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat e përcaktuara sipas Nenit 10 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) – NR.17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
4. Përgjegjësitë dhe detyrat e komisionit të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, janë:
 - 4.1. organizon numrin e nevojshëm të komisioneve profesionale për vlerësimin e dëmeve dhe përcakton zonën përkatëse për secilin komision. Në rastet e dëmeve të përmasave të vogla vlerësimin e dëmeve e kryen vetë komisioni lokal;
 - 4.2. cakton afatin deri kur duhet të kryhet vlerësimi i dëmeve;
 - 4.3. kujdeset për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje
 - 4.4. bashkon punën e të gjitha komisioneve profesionale në territorin e komunës dhe ju ofron ndihmën e nevojshme profesionale;

4.5. përpilon raportin përmbledhës për dëmet e vlerësuara në territorin e komunës dhe ia dorëzon kryetarit të komunës për shqyrtim;

4.6. raportin e miratuar nga asambleja komunale ia dorëzon Agjencisë në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit dhe një kopje ia dorëzon komisionit qendror;

4.7. propozon prioritetet për shfrytëzimin e mjeteve të ndara për sanimin dhe mënjanimin e pasojave që kanë ndodh nga fatkeqësia dhe për këtë e njofton kryetarin e komunës dhe

4.8. mbanë evidencë për dëmet e shkaktuara në territorin e komunës.

5. Mandati i komisionit të cekur sipas pikës 2 të këtij Vendimi, është katër (4) vjeçar.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

